

## **TË MËSOSH (ARSIMI) NË ANTWERPEN**

### **Regjistrimi i fëmijës suaj në një kopësht apo në një shkollë fillore në Antwerpen**

Viti shkollor 2012-2013

#### **Përmbajtja**

Parathënie	4
Së pari bëhet paraqitja e pastaj regjistrimi	5
Cilët fëmijë duhet t'i paraqitni?	6
Kur duhet të paraqitni fëmijën tuaj?	7
Paraqitja e fëmijëve për një shkollë ku vëllai apo motra e saj është i/e regjistruar	8
Paraqitja e fëmijëve për një shkollë ku vëllai apo motra e saj nuk është i/e regjistruar	12
Pyetje të bëra shpesh	16
Qendrat e paraqitjes	24

## **Parathënie**

I dashur prind

Fëmija juaj vë në shkollë bazën e të ardhmes së tij / së saj. Prandaj ju nuk zgjedhni pa u menduar një shkollë për djaln ose vajzën tuaj. E ardhmja e tij ose e saj është gjithashtu i rëndësishëm për ne. Me sistemin e regjistrimeve për kopështet dhe shkollat fillore të Antwerpen-it dëshirojmë t'ju japim të gjitha mundësitë për të regjistruar fëmijën tuja në shkollën që ju e zgjedhni. Për t'a regjistruar fëmijën tuaj, ju duhet së pari t'a paraqitni.

### **Pse (duhet) një sistem qendror paraqitjesh?**

Kopështet dhe shkollat fillore të Antwerpen-it punojnë që dy vite me një sistem me të cilin prindërit mund të paraqesin fëmijët e tyre me anë të internetit. Kështu, ne parandalojmë ndër të tjera pritjen në portën e shkollës dhe të gjithë prindërve u jepen mundësi të njëjta për të regjistruar fëmijën / fëmijët tuaj në shkollën që ju zgjedhni.

Të gjitha kopështet dhe shkollat fillore në qytetin e Antwerpen-it punojnë me këtë sistem. Kjo merr gjithashtu parasysh përparësinë ligjore për për shembull fëmijët që kanë tashmë një vëlla ose një motër në të njëjtën shkollë.

Kjo broshurë ju tregon hap pas hapi se çfarë duhet të bëni për të regjistruar fëmijën tuaj në një kopësht ose një shkollë fillore në Antwerpen. Nëse keni pyetje mbi sistemin e paraqitjes, atëherë ejani në një nga seancat informative. Datat dhe vendet (ku dhe kur duhet shkuar) mund t'i gjeni tek faqja e prapme e kësaj broshure. Edhe punonjësit e de Studiewijzer (Qendra e udhëzimit për Studimet) janë të gatshëm t'ju përgjigjen. Të dhënat e tyre të kontaktit mund t'i gjeni në pjesën e prapme të kësaj broshure.

Unë ju uroj tashmë shumë suksese në gjetjen e një shkollë ku fëmija juaj ndihet si në shtëpinë e tij.

Luc Tesseur

Kryetar i Lokaal overlegplatform basisonderwijs (Platforma Lokale e diskutimit në arsimin fillor)

## **Së pari bëhet paraqitja e pastaj regjistrimi.**

Regjistrimin e fëmijës suaj në një kopësht apo shkollë fillore të Antwerpen-it duhet t'a bëni në dy faza:

1. Paraqiteni fëmijën tuaj për në shkollat që ju keni zgjedhur në faqen e internetit [meldjeaan.antwerpen.be](http://meldjeaan.antwerpen.be).
2. Pastaj ju dërgohet një letër me të dhënat e shkollës se ku mund t'a regjistroni fëmijën tuaj dhe lini një takim me shkollën. Regjistrimi bëhet definitiv (i sigurtë) në momentin kur ju nënshkruani (firmosni) regjistrin e regjistrimeve.

## **A jeni i detyruar të bëni paraqitjen e fëmijës suaj?**

Nuk është e detyrueshme me ligj që të përdorni sistemin e paraqitjeve, por ne ju këshillojmë me ngulmim që t'a përdorni atë. Nëse ju nuk e paraqitni fëmijën tuaj, atëherë ju mund t'a regjistroni atë në një kopësht apo shkollë fillore të Antwerpen-it vetëm datës 6 qershor 2012. Në atë moment në shumë shkolla nuk do ketë më vende të lira.

## **Cilët fëmijë duhet t'i paraqitni?**

- Të gjithë fëmijët e lindur në 2010
- Të gjithë fëmijët e lindur në 2007, 2008, 2009 që nuk janë regjistruar akoma në një shkollë/kopësht.
- Fëmijët që futen në klasën e parë në vitin shkollor 2012-2013:
  - > Ndonjëherë është e nevojshme që fëmijët, që rrijnë në të njëjtën shkollë, t'i regjistroni sërish. Kërkoni informacione në shkollë.
- Të gjithë fëmijët që shkojnë në një kopësht apo shkollë fillore tjetër në vitin shkollor 2012-2013.

## **Vini re:**

- Nëse fëmija juaj ka lindur pas datës 13 nëntor 2010, Është mira që t'a paraqitni fëmijën tuaj që tani. Edhe në rast se ajo mund të shkojë në shkollë jo para shatorit 2013. Kështu ju keni më tepër mundësi të rezervoni një vend të lirë në shkollën që preferoni.
- Nëse fëmija juaj duhet të futet vitin tjetër në arsimin e jashtëzakonshëm, atëherë lexoni për më tej në faqen 6.

## **Kur duhet të paraqitni fëmijën tuaj?**

A dëshironi t'a regjistroni fëmijën tuaj në një kopësht apo në një shkollë fillore ku është i regjistruar tashmë një vëlla apo një motër e saj?

### **PO**

Atëherë paraqiteni fëmijën tuaj nga 11 janari deri më 1 shkurt.

Nga faqja 4 mund të gjeni të gjitha informacionet për t'a paraqitur fëmijën tuaj hap pas hapi.

### **JO**

Atëherë paraqiteni fëmijën tuaj nga 15 shkurti deri më 14 mars. Nga faqja 5 mund të gjeni të gjitha informacionet për t'a paraqitur fëmijën tuaj hap pas hapi.

Nga faqja 7 mund të gjeni një listë me pyetjet që janë bërë shpesh. Nëse ju megjithatë keni një pyetje specifike që kjo broshurë nuk i përgjigjet, atëherë mos ngurroni të kontaktoni "de

Studiewijzer”. Bashkëpunëtorët tanë do të kërkojnë sa më shpejt të jetë e mundur një përgjigje për pyetjen tuaj. Në pjesën e prapme të kësaj broshure mund të gjeni të dhënat për të kontaktuar.

## **Paraqitja e fëmijëve për një shkollë ku vëllai apo motra e saj është i/e regjistruar.**

### **Hapi 1: Paraqiteni fëmijën tuaj**

#### ***Kur?***

Nga e mërkura më 11 janar ora 09:30 deri të mërkurën më 1 shkurt ora 23:30. Ju mund të paraqitni fëmijët vetëm për atë shkollë ku është i/e regjistruar tashmë një vëlla apo një motër.

**Gjë e rëndësishme t’ a dini :** Momenti se kur ju e paraqitni fëmijën tuaj nuk është këtë vit më i rëndësishëm për të përcaktuar rradhitjen. Pra ju mund të shfrytëzoni pa u ngutur të gjithë periudhën e paraqitjes për të paraqitur fëmijën tuaj dhe për të ndryshuar të dhënat tuaja.

#### **Çfarë nevojitet**

- Numri i fëmijës suaj në regjistrin kombëtar(rijksregisternummer). Ju mund t’ a gjeni në kartën SIS ose në kartën e identitetit të fëmijës suaj. Nëse ju nuk e gjeni numrin e regjistrin kombëtar, atëherë merrni kontakt me “de Studiewijzer” (shikoni informacionet në kapërtinën e prapme të kësaj broshure) ose shkoni në një qendër paraqitjeje (aanmeldpunt) (shikoni informacionet në faqen 11).
- Një kompjuter me lidhje interneti. Nëse ju nuk keni lidhje interneti, atëherë ju mund të shkoni në disa vende të ndryshme. Informacione të mëtejshme gjeni në faqen 11.

#### **Si?**

- Shkoni në faqen e internetit [meldjeaan.antwerpen.be](http://meldjeaan.antwerpen.be)
- Ndiqini hapat që ju paraqiten në ekran.
- Zgjidhni një fjalëkalim (paswoord) dhe një emër përdoruesi (gebruikersnaam). Ruajini mirë ato. Ato ju nevojiten nëse do të kontrolloni (shikoni), apo të ndryshoni të dhënat tuaja. Kjo mund të bëhet deri më dhe përfshi të mërkurën më 1 shkurt 2012.

#### **Nëse keni nevojë për ndihmë**

Ka organizata që ju ndihmojnë me gjithë dëshirë. Ju mund të gjeni një listë në faqen 11. Ose telefononi në Studiewijzer (Udhëzuesi i Studimeve) në numrin 03 338 33 66.

### **Hapi 2: Ju dërgohet një letër ose një e-mail**

Deri më 17 shkurt ju dërgohet një letër ose një e-mail. Në të është shkruar nëse ju mund t’ a regjistroni fëmijën tuaj në shkollën e vëllait apo motrës (së saj).

Në raste të jashtëzakonshme mund të ndodhë që një shkollë të mos ketë mjaftueshëm vende për vëllezërit dhe motrat. Në atë rast bashkëpunëtorët e Studiewijzer do t’ ju kontaktojnë personalisht. Në të rast ju duhet t’ a paraqitni fëmijën tuaj nga data 15 shkurt edhe një herë për në një shkollë tjetër. Të gjitha informacionet mund t’ i gjeni nga faqja 5.

### Hapi 3: Regjistrojeni fëmijën tuaj.

Fëmija juaj nuk është i regjistruar nëse ajo është paraqitur. Pra ju duhet t'a regjistroni fëmijën tuaj efektivisht në shkollën që është përmendur në letër.

#### Kur?

Nga 1 marsi deri dhe përfshi 23 maj 2012.

#### Si?

- Lini një takim me shkollën që përmendet në letër ose në e-mail.
- Shkoni në shkollë për të regjistruar fëmijën tuaj.
- Nënshkruajeni regjistrin e regjistrimeve në shkollë
- Kërkoni një provë regjistrimi.

paraqitja ≠ (nuk është e njëjta gjë si) regjistrimi

**Paraqitja e fëmijëve për një shkollë ku vëllai apo motra e saj nuk është i/e regjistruar.**

### Hapi 1: Zgjidhni një shkollë

#### Kur?

Para se të paraqitni fëmijën tuaj.

#### Si?

- Ju mund të gjeni një pasqyrë të plotë të kopështëve dhe të shkollave fillore në Antwerpen në listën e shkollave që ndodhet në këtë broshurë.
- Bëni, për vete, këtu poshtë një listë me shkollat ku ju dëshironi t'a regjistroni fëmijën tuaj. Zgjidhni pesë shkolla ose më shumë. Kështu ju keni më tepër mundësi të gjeni një vend në shkollën që keni zgjedhur.
- Rradhitini shkollat sipas preferencës suaj. Shkollën më të preferuar vendoseni gjithmonë në numrin 1. Të gjitha shkollat që zgjedhni janë shkollat e preferuara. Ju keni automatikisht më shumë mundësi t'ju caktohet një vend i lirë në një nga tre shkollat e para.

	Emri i shkollës	Kodi postar
Shkolla 1		
Shkolla 2		
Shkolla 3		
Shkolla 4		
Shkolla 5		
...		
...		
...		

## Hapi 2: Paraqiteni fëmijën tuaj

### Kur?

Nga e mërkura më 15 shkurt ora 09:30 deri dhe përfshi të mërkurën më 14 mars 2012 ora 23:30.

**Gjë e rëndësishme t'a dini :** Momenti se kur ju e paraqitni fëmijën tuaj nuk është këtë vit më i rëndësishëm për të përcaktuar rradhitjen. Pra ju mund të shfrytëzoni pa u ngutur të gjithë periudhën e paraqitjes për të paraqitur fëmijën tuaj dhe për të ndryshuar të dhënat tuaja.

### Çfarë nevojitet

- Listën tuaj të shkollave, ku dëshironi të regjistroni fëmijën tuaj, me kodet e tyre postare.
- Numri i fëmijës suaj në regjistrin kombëtar (rijksregisternummer). Ju mund t'a gjeni në kartën SIS ose në kartën e identitetit të fëmijës suaj. Nëse ju nuk e gjeni numrin e regjistrit kombëtar, atëherë merrni kontakt me "de Studiewijzer" (shikoni informacionet në kapërtinën e pasme të kësaj broshure) ose shkoni në një qendër paraqitjeje (aanmeldpunt) (shikoni informacionet në faqen 11).
- Një kompjuter me lidhje interneti. Nëse ju nuk keni kompjuter apo lidhje interneti, atëherë ju mund të shkoni në disa vende të ndryshme. Informacione të mëtejshme gjeni në faqen 11.

### Si?

- Shkoni në faqen e internetit <http://meldjeaan.antwerpen.be>
- Ndiqini hapat që ju paraqiten në ekran.
- Zgjidhni një fjalëkalim (paswoord) dhe një emër përdoruesi (gebruikersnaam). Ruajini mirë ato. Ato ju nevojiten nëse do të kontrolloni (shikoni) apo të ndryshoni të dhënat tuaja. Kjo mund të bëhet deri dhe përfshi të mërkurën më 14 mars.

### Nëse keni nevojë për ndihmë

Ka organizata që ju ndihmojnë me gjithë dëshirë. Ju mund të gjeni në këtë broshurë një listë në faqen 11. Ose telefononi në Studiewijzer (Udhëzuesi i Studimeve) në numrin 03 338 33 66.

## Hapi 3: Ju dërgohet një letër ose një e-mail

Deri më 30 mars ju dërgohet një letër apo një e-mail. Në të është shkruar se në cilën shkollë ju mund t'a regjistroni fëmijën tuaj.

Nëse nuk asnjë shkollë ku mund t'a regjistroni fëmijën tuaj, atëherë de Studiewijzer do të marrë personalisht kontakt me ju. Bashkëpunëtorët e Studiewijzer mund t'ju tregojnë nga data 4 qershor 2012 se në cilat shkolla ka vende të lira. Regjistrimet mund të bëhen duke filluar nga data 6 qershor 2012.

## Hapi 4: Regjistrojeni fëmijën tuaj.

Fëmija juaj nuk është e regjistruar nëse ajo është paraqitur. Pra ju duhet t'a regjistroni fëmijën tuaj efektivisht në shkollën që është përmendur në letër.

### Kur?

Nga 18 prilli deri dhe përfshi 23 maj 2012.

### Si?

- Lini një takim me shkollën që përmendet në letër apo në e-mail.
- Shkoni në shkollë për t'a regjistruar fëmijën tuaj.
- Nënshkruajeni regjistrin e regjistrimeve në shkollë
- Kërkoni një provë regjistrimi.

paraqitja ≠ (nuk është e njëjta gjë si) regjistrimi

## Pyetje të bëra shpesh mbi sistemin e paraqitjeve

Këtu poshtë ju japim një përgjigje për disa pyetje. Nëse megjithatë keni ndonjë pyetje të veçantë, atëherë bëja ato Studiewijzer-it. Bashkëpunëtorët tanë do t'ju ndihmojnë me dëshirë. Në pjesën e prapme të kësaj broshure mund të gjeni të dhënat e tyre të kontaktit. Ju mund të merrni gjithashtu pjesë në një nga seancat informative për prindërit në Den Bell, Francis Wellesplein 1, 2018 Antwerpen. Këto seanca zhvillohen më :

XXXXXX

Nuk ka nevojë të regjistroheni (në to).

### 1. Për në cilat shkolla mund t'a regjistroj unë fëmijën time?

Ju mund t'a paraqitni fëmijën tuaj për të gjitha kopështet dhe shkollat fillore të të gjitha rrjeteve arsimore në qytetin e Antwerpen-it. Një pasqyrë të të gjitha shkollave mund t'a gjeni tek lista e shkollave në këtë broshurë. Është mira t'a paraqitni fëmijën tuaj për disa shkolla. Sigurisht që kjo gjë nuk do të thotë se në këtë rast ju keni më pak mundësi të të gjeni një vend në shkollën që preferoni! Duke dhënë më tepër se një shkollë, ju i rrisni mundësinë tuaj për të regjistruar fëmijën tuaj në një shkollë që ju e zgjedhni vetë.

Nëse fëmija juaj shkon në vitin e ardhshëm shkollor në një shkollë të arsimit të jashtëzakonshëm, atëherë ju nuk duhet t'a paraqitni atë. Ju mund t'a regjistroni fëmijën tuaj drejt për së drejti në shkollë. Nëse fëmija juaj ka një vërtetim për arsimin e jashtëzakonshëm, por nëse ju dëshironi t'a regjistroni atë në një shkollë të zakonshme (normale), atëherë duhet t'a përdorni sistemin e paraqitjeve.

### 2. A është i rëndësishëm momenti se kur e paraqitni fëmijën tuaj?

Këtë vit, momenti se kur e paraqitni fëmijën tuaj nuk është më i rëndësishëm për përcaktuar rradhitjen. Pra ju mund të shfrytëzoni pa u ngutur të gjithë periudhën e paraqitjes për të paraqitur fëmijën tuaj dhe për të ndryshuar të dhënat tuaja.

### 3. Si ndahen vendet e lira?

Pas periudhave të paraqitjeve caktohet për çdo kopësht dhe shkollë fillore në Antwerpen një rradhitje për të gjithë fëmijët që janë paraqitur. Sipas ligjit janë dy grupe fëmijësh, që kanë përparësi në regjistrim :

- Fëmijët me një vëlla ose motër që është i/e regjistruar në të njëjtën shkollë. Për këtë grup vlen përparësia absolute, nëse ka vende të mjaftueshme në shkollë.
- Nxënësit e kategorisë GOK ose ata që nuk bëjnë pjesë në këtë kategori, nëse shkolla zgjedh për këtë (GOK është Gelijke OnderwijsKansen - Mundësitë e Barabarta për Arsimim). Por numri i vendeve për këtë grup është i kufizuar. Informacione të mëtejshme mbi kriteret e GOK mund të gjeni tek përgjigjet e pyetjeve 5 dhe 6.

Nëse shkolla ka më tepër paraqitje se vende të lira, atëherë të gjithë fëmijët e paraqitur rradhiten në bazë të këtyre kriterëve:

- preferancë
  - > ju jepet një mundësi shtesë në përcaktimin e vendeve të lira për tre shkollat e para për të cilat e paraqit fëmijën tënde.
- largësia
  - > largësia nga shkolla deri në vendbanimin e fëmijës
  - > largësia nga shkolla deri në vendin e punës së nënës dhe/ose babait

Çdo shkollë e cakton vetë se sa vende të lira i ndajnë për kriter. Këtë informacion mund t'a gjeni në listën e shkollave që i bashkangjitet kësaj broshure. Por shkollat duhet të ndajnë së paku 50% të vendeve në bazë të largësisë.  $\frac{3}{4}$  nga këta vende ndahen në bazë të largësisë nga shkolla deri në

vendbanimin e fëmijës. Vandet e mbatura ndahen në bazë të largësisë nga shkolla deri tek vendi i punës së babait dhe/ose nënës së fëmijës.

Momenti i paraqitjes nuk është më kriter për rradhitjen, për paraqitjet e vitit shkollor 2012-2013. Pra nuk ka më rëndësi se kur e paraqet fëmijën tuaj. Pra ju mund të shfrytëzoni periudhën e paraqitjeve të plotë, për të paraqitur fëmijën tuaj.

Këshillë: bashkangjitur kësaj broshure mund të gjeni një karton shënues faqesh me të gjitha datat kur de Studiewijzer organizon seanca të zgjeruara informative mbi funksionimin e regjistrimit të paraqitjeve dhe mbi ndarjen e vendeve të lira.

#### **4. Përse është mira që të zgjedh më tepër se një shkollë?**

Ne ju këshillojmë të zgjedhni pesë ose më shumë shkolla. Në këtë mënyrë ju keni më shumë mundësi të keni një vend në një nga shkollat që ju preferoni. Mos harroni t'i rradhitni shkollat sipas preferencës suaj. Edhe nëse ka vetëm pak vende apo nuk ka aspak vende të lira në shkollën tuaj të preferuar, vendose atë (shkollën e preferuar) gjithmonë në vendin e parë. Të gjitha shkollat që ju zgjedhni janë shkollat e preferuara. Për tre shkollat e para, ju keni më tepër mundësi t'ju caktohet një vend. Kur ndahen vendet e lira merren pra parasysh së pari me këto tre shkolla.

Së pari shikohet nëse ka vende të lira në shkollën që ju e keni vënë në vend të parë (shkolla 1). Nëse ka vend për fëmijën tuaj në këtë shkollë, ju dërgohet një letër ose një e-mail që ju mund t'a regjistroni fëmijën tuaj në këtë shkollë. Nëse nuk ka më vende në shkollën 1, atëherë i vjen rradha shkollës që e keni vënë në vend të dytë (shkolla 2). Nëse ka vend për fëmijën tuaj në këtë shkollë, ju dërgohet një letër ose një e-mail që ju mund t'a regjistroni fëmijën tuaj në këtë shkollë. Në atë rast fëmija juaj vendoset automatikisht në listën e pritjes së shkollës 1.

Ky hap përsëritet për të gjitha shkollat e juaja të preferuara që keni deklaruar. Ju caktohet vendi i lirë në shkollën, që për ju gëzon preferencën më të madhe. Kjo do të thotë se ju nuk keni më të drejtë të kërkonte një vend në një shkollë që rradhitet më poshtë (në preferencën tuaj. Nëse më vonë lirohet një vend në shkollën ku fëmija juaj është në listën e pritjes, atëherë ka mundësi që megjithatë fëmija juaj të mund të regjistrohet në atë shkollë. Kjo është e mundur edhe nëse ndërkohë fëmija juaj është regjistruar në një shkollë tjetër. Shkolla do t'ju kontaktojë për këtë gjë. Lista e pritjes është e vlefshme deri dhe përfshi më 14 shtator 2012.

#### **5. Çfarë janë nxënësit e kategorisë GOK dhe ata që nuk hyjnë në këtë kategori?**

Sipas ligjit nxënësit e kategorisë GOK dhe ata që nuk hyjnë në këtë kategori kanë përparësi në regjistrim. Disa shkolla i japin përparësi nxënësve që hyjnë në kategorinë e Mundësive të Barabarta për Arsimim (GOK). Por shkolla të tjera zgjedhin për t'i dhënë përparësi nxënësve që nuk hyjnë në kategorinë GOK. Në listën e shkollave bashkangjitur kësaj broshure është shkruar përkrah çdo shkolle nëse i jep përparësi nxënësve të kategorisë GOK apo nxënësve që nuk hyjnë në kategorinë GOK.

#### **6. A hyn fëmija ime në kategorinë GOK apo nuk është i kategorisë GOK?**

Përgjigjiu pyetjeve vijuese. Nëse përgjigjja e një ose më tepër pyetjeve është 'po', atëherë fëmija juaj hyn në kategorinë e nxënësve GOK. Nëse përgjigjja e të gjitha pyetjeve është 'jo', atëherë fëmija juaj nuk hyn në kategorinë e nxënësve GOK.

- A merr familja juaj një bursë studimesh (arsimore)?
- A nuk e ka marrë nëna diplomën e arsimit të mesëm?
- A strehohet fëmija (përkohësisht) jashtë familjes?

- A i përkasin prindërit grupit të popullatës që shpërngulen (rregullisht)? Për shembull: a banojnë ata në një anije ose në një karavan (autokamp)?
- A flet fëmija me prindërit, me vëllezërit, me motrat ose me shokët në një gjuhë tjetër përveç holandishtes?

Kur të paraqiteni në faqen e internetit <http://meldjeaan.antwerpen.be>, mund t'iu përgjigjeni këtyre pyetjeve. Ka mundësi që edhe gjatë regjistrimit në shkollë duhet të sidhni me vete dokumenta të tjera ose duhet të nënshkruani një deklaratë ku betoheni që deklaroni të vërtetën. Prandaj, jepni një përgjigje të vërtetë kur të bëni paraqitjen. Në fletën që duhet plotësuar në mes të kësaj broshure mund të gjeni informacione shtesë mbi listën me pyetje.

### **7. Cilën adresë të banesës duhet të jap?**

Përveç adresës zyrtare ju mund të jepni edhe një 'adresë faktike'. Adresa faktike është adresa ku fëmija juaj kalon së paku tre netë në javë. Kjo mund të jetë një konvikt shkolle, një familje adoptuese, prindi tjetër (nëse prindërit nuk banojnë bashkë), një pjesëtar tjetër i familjes... Përmend këtë adresë faktike nëse dëshiron që kjo adresë të përdoret në llogaritjen e largësisë së vendbanimit dhe shkollës. Adresa që jepni përdoret për të gjitha shkollat që zgjedhni. Pra ju nuk mund të jepni dy adresa të ndryshme për dy shkolla të ndryshme. As një adresë e një çerdheje apo e një nëne që ruan fëmijët në shtëpinë e saj, nuk vlen, sepse në përgjithësi fëmijët nuk e kalojnë natën aty. Largësia llogaritet në distancë ajrore.

### **8. Përse duhet të jap adresën e vendit tim të punës?**

Përveç adresës së banesës mund të jepni edhe adresën e vendit tuaj të punës. Ju mund të jepni deri në dy adresa të vendit të punës. Ne ju këshillojmë t'a plotësoni (jepni) këtë adresë. Kjo gje vetëm se e rrit mundësinë që të merrni një vend në shkollën që keni zgjedhur. Largësia e shkollës deri tek vendi i punës llogaritet në distancë ajrore.

### **9. Ku mund t'a gjej numrin në regjistrin kombëtar të fëmijës sime (rijksregisternummer)?**

Numrin në regjistrin kombëtar mund t'a gjeni tek karta SIS ose tek karta e identitetit (Kids-ID) e fëmijës suaj. Nëse nuk e gjeni numrin në regjistrin kombëtar, mund të merrni kontakt me de Studiewijzer (shiko informacionet në kopertinën e prapme të kësaj broshure) ose shko tek një qendër paraqitjeje (shiko informacionet në faqen 11).

### **10. Si mund t'i ndryshoj të dhënat e mija në sistemin e paraqitjeve?**

Ju mund t'i ndryshoni të dhënat tuaja gjatë të gjithë periudhës së paraqitjeve. Kur të paraqiteni për herë të parë në sistem ju duhet të zgjedhni një fjalëkalim (password) dhe një emër përdoruesi (gebruikersnaam). Ruajti mirë këto. Do t'ju nevojiten nëse doni t'i shikoni ose t'i ndryshoni të dhënat tuaja. Për paraqitjen e vëllezërve dhe të motrave kjo mund të bëhet nga 11 janari deri më 1 shkurt. Për të gjithë fëmijët e tjerë nga 15 shkurti deri më 14 mars.

### **11. Çfarë të bëj nëse nuk kam kompjuter ose internet?**

Nëse vetë nuk keni kompjuter me lidhje në internet ose nëse nuk mund të përdorni kompjuterin, atëherë ju mund të ndihmoheni në qendra të ndryshme të paraqitjeve për të paraqitur fëmijën tënde. Udhëzues (asistentë) në këto qendra të paraqitjeve do t'ju ndihmojnë për t'a paraqitur fëmijën tuaj hap pas hapi. Në këtë mënyrë jeni të sigurtë se e keni paraqitur në mënyrë korrekte fëmijën tuaj për shkollat që i preferoni. Një pasqyrë të qendrave të paraqitjeve mund t'a gjeni në faqen 11 të kësaj broshure.

Natyrisht që ju mund të rezervoni një kompjuter me lidhje në internet edhe në bibliotekat e bashkive (komunave).

## **12. Çfarë ndodh pas paraqitjes sime?**

Pasi ju e keni paraqitur fëmijën tuaj, ju dërgohet një mesazh (letër) se cila shkollë ka vend për fëmijën tuaj. Me këtë letër mund të shkoni tek shkolla për t'a regjistruar efektivisht fëmijën tuaj. Regjistri i paraqitjeve merr gjithmonë parasysh rradhitjen e zgjedhjes suaj. Nëse një ose disa shkolla që ju i kishit rradhitur më lart, nuk ka më vend të lirë, atëherë fëmija juaj vendoset automatikisht në listën e pritjes së këtyre shkollave. Nëse megjithatë lirohet një vend, atëherë shkolla do t'ju kontaktojë. Nëse dëshiron mund t'a regjistroni fëmijën tuaj, edhe pse me pak vonesë, në shkollën tuaj të preferuar. Kjo mund të bëhet edhe nëse fëmijën tuaj e keni regjistruar tashmë në një shkollë tjetër.

Ki kujdes! Nëse fëmijën tuaj nuk e regjistron para 23 majit 2012, atëherë vendi juaj lirohet për vijuesin në rradhitje.

## **13. Çfarë është një dokument refuzimi (weigeringsdocument)?**

Nga shkollat për të cilat e keni paraqitur fëmijën tuaj, por që ato për momentin nuk kanë më vend të lirë, ju jepet një dokument refuzimi. Ka mundësi që t'ju jepen disa dokumente refuzimi. Çdo dokument refuzimi është i lidhur me një shkollë të veçantë. Fëmija juaj vendoset automatikisht në listat e pritjes së këtyre shkollave. Pra një dokument refuzimi është prova objektive e vendit tuaj në listën e pritjes së një shkolle.

Nëse nuk ka asnjë shkollë ku mund t'a regjistroni fëmijën tuaj, atëherë de Studiewijzer merr personalisht kontakt me ju.

## **14. Çfarë ndodh nëse nuk kam vend për fëmijën time?**

Në raste të rralla ndodh që ju nuk gjeni vend edhe nëse e keni paraqitur fëmijën tuaj në mënyrë korrekte. De Studiewijzer ka, nga 4 qershori, një pasqyrë të shkollave, që kanë akoma vende të lira dhe bashkë me ju kërkon zgjidhjen më të mirë. Nga 6 qershori 2012 mund t'a regjistroni fëmijën tuaj në një nga ato shkolla.

## **15. Çfarë ndodh nëse nuk e kam paraqitur në kohë fëmijën time?**

Kur të kalojë periudha e përparësive për fëmijët me një vëlla ose motër në të njëjtën shkollë, nga 11 janari deri më 1 shkurt, ju mund t'a paraqitni fëmijën tuaj gjithnjë nga 15 shkurti deri dhe përfshi më 14 mars. Momenti se kur e paraqitni fëmijën tuaj nuk është aspak i rëndësishëm.

Ki kujdes: në atë moment fëmija juaj nuk ka më përparësi kundrejt fëmijëve të tjerë që paraqiten. Nëse nuk e keni paraqitur fëmijën tuaj para 14 marsit, ju nuk keni vend në rradhitje.

Bashkëpunëtorët e de Studiewijzer do t'ju tregojnë, nga 4 qershori, se cilat shkolla kanë akoma vende të lira për fëmijën tënde.

Ki kujdes: ju do të keni më pak mundësi për të zgjedhur sepse fëmijët e paraqitur patën tashmë mundësinë për t'u regjistruar. Pra në shumë shkolla nuk do të jenë vende të lira.

## **16. Çfarë ndodh nëse nuk e kam regjistruar në kohë fëmijën time?**

Ju mund t'a regjistroni fëmijën tuaj deri dhe përfshi më 23 maj 2012. Pastaj ju e humbisni vendin tuaj në rradhitje. Në atë moment ju mund t'a regjistroni fëmijën tuaj vetëm në një shkollë, që ka vende të lira pas 6 qershorit. Bashkëpunëtorët e de Studiewijzer do t'ju tregojnë, nga 4 qershori, se cilat shkolla kanë akoma vende të lira për fëmijën tënde.

Ki kujdes: ju do të keni më pak mundësi për të zgjedhur sepse fëmijët e paraqitur patën tashmë mundësinë për t'u regjistruar. Pra në shumë shkolla nuk do të jenë vende të lira.

Nëse megjithatë keni ndonjë pyetje të veçantë të cilës kjo broshurë nuk i përgjigjet, atëherë mos ngurro të marrësh kontakt me de Studiewijzer. Bashkëpunëtorët tanë do të kërkojnë sa më shpejt të jetë e mundur një përgjigje për pyetjen tuaj. Të dhënat e tyre të kontaktit mund t'i gjeni në anën e prapme të kësaj broshure.

## Qendrat e paraqitjes

Nëse dëshironi të ndihmoheni për të paraqitur fëmijën tuaj, atëherë mund të shkoni në një nga qendrat e mëposhtme të paraqitjes :

Studiewijzer
Francis Wellesplein, 2018 Antwerpen
Orari i hapjes: më 11-1-12 dhe më 15-2-12 nga ora 9:30 deri ora 17:00. Çdo ditë pune ora 13:00 deri ora 16:00

Ontmoetingscentrum NOVA
Schijfstraat 105, 2020 Antwerpen (Kiel)
Orari i hapjes: më 11-1-12 dhe më 15-2-12 nga ora 9:30 deri ora 17:00. Të martën ora 13:00 deri ora 16:00

Inburgering Antwerpen
Atlas – Carnotstraat 110, 2060 Antwerpen
Orari i hapjes: më 11-1-12 dhe më 15-2-12 nga ora 9:30 deri ora 19:30. Të hënën deri të enjten nga ora 9:30 deri ora 12:00 dhe ora 13:00 deri ora 16:00, të martën edhe nga ora 17:00 deri ora 19:30

Inloopteam Samik
Centrum De Wijk, Willy Vandersteenplein 1, 2060 Antwerpen
Orari i hapjes: më 11-1-12 nga ora 9:30 deri ora 17:00. Gjatë periudhës së paraqitjeve për vëllezërit dhe motrat : të hënën nga ora 10:00 deri ora 12:00 Më 15-2-12 ora 09:30 deri ora 17:00, Gjatë periudhës së paraqitjeve për të gjithë të hënën deri të enjten nga ora 10:00 deri ora 12:00

De 8
De Shelter, Meldpunt Onderwijs, Langstraat 102, 2140 Borgerhout
Orari i hapjes: më 11-1-12 dhe më 15-2-12 nga ora 9:30 deri ora 18:00. Të hënën, të martën dhe të enjten nga ora 9:00 deri ora 18:00, të mërkurën ora 10:00 deri ora 18:00 të premten ora 09:00 deri ora 17:00

Stedelijk basisonderwijs Antwerpen
Administratief centrum Het Anker, Lamoriniërestraat 227, 2018 Antwerpen
Orari i hapjes: më 15-2-12 nga ora 9:30 deri ora 11:00 dhe ora 14:00 deri ora 18:00. Më 28-2-12 nga ora 9:30 deri ora 11:00 dhe ora 15:00 deri ora 17:00. Më 7-3-12 nga ora 9:30 deri ora 12:00. Të gjitha ditët e punës nga ora 9:30 deri ora 11:00

Buurtsecretariaat Linkeroever
Ernest Claesstraat 10 (Europark), 2050 Antwerpen - Linkeroever
Orari i hapjes: më 11-1-12 dhe më 15-2-12 nga ora 9:30 deri ora 17:00 Të mërkurën ora 10:00 deri ora 16:00

Buurtsecretariaat Sint-Andries
Cultureel ontmoetingscentrum Sint-Andries (coStA), Sint-Andriesplaats 24,

2000 Antwerpen
Orari i hapjes: më 11-1-12 dhe më 15-2-12 ora 10:00 deri ora 17:00?
Të martën dhe të enjten ora 13:30 deri ora 16:30

Buurtsecretariaat Luchtbal
Hondurasstraat 6-8, 2030 Antwerpen (Luchtbal)
Orari i hapjes: më 11-1-12 dhe më 15-2-12 ora 9:30 deri ora 17:00
Të premtën ora 10:00 deri ora 12:00 → ora 10 deri ora 15:00?

Buurthuis 't Pleintje
2100 Deurne

Buurthuis Posthof
Patriottenstraat 62, 2600 Berchem
Orari i hapjes: më 11-1-12 dhe më 15-2-12 ora 9:30 deri ora 17:00
Të hënën ora 14:00 deri ora 17:00, të martën, të mërkurën të enjten ora 9:00 deri ora 17:00, të premtën ora 9:00 deri ora 16:00

Buurthuis Dinamo
2100 Deurne

Digipunt Atel
2170 Merksem

Buurthuis De Zwaantjes
2660 Hoboken

### Colofon

Regjistri qendror i paraqitjeve është një iniciativë e het Lokaal OverlegPlatform (LOP-Platformës Lokale të Diskutimit), ku janë të përfaqësuar të gjitha shkollat fillore të Antwerpen-it.

Përgjegjës i botimit : Luc Tesseur, LOP basisonderwijs Antwerpen

Wettelijk depot (depozita zyrtare): **D/2011/0306/319**

Tetor 2011

## **Së pari bëhet paraqitja e pastaj regjistrimi.**

### **Paraqitja:**

Fëmijët me një vëlla ose motër në të njëjtën shkollë:  
nga e mërkura më 11 janar deri dhe përfshi të mërkurën më 1 shkurt 2012

Të gjithë fëmijët e tjerë:  
nga e mërkura më 15 shkurt deri dhe përfshi të mërkurën më 14 mars 2012.

### **Regjistrimi:**

Deri (dita e fundit) të mërkurën më 23 maj 2012

Nëse keni pyetje të mëtejshme ose nëse keni nevojë për ndihmë. De Studiewijzer ju ndihmon me dëshirë!

Edhe organizatat e tjera mund t'ju japin informacione dhe mund t'ju ndihmojnë për paraqitjen. Në faqen 11 të kësaj broshure mund të gjeni një listë me këto organizata.

Ose ejani në një nga shumë seancat informative. Shiko në faqen **xx** për një pasqyrë të orareve dhe vendeve.

### **Ku?**

Den Bell  
Francis Wellesplein 1  
2018 Antwerpen

### **Kur?**

Të hënë deri të premten ora 13:00 deri ora 16:00, ose pasi të keni marrë një takim.  
Mbyllur nga 26 dhjetori 2011 deri më 1 janar 2012.

Numri i telefonit: 03 338 33 66

E-mail: [studiewijzer@stad.antwerpen.be](mailto:studiewijzer@stad.antwerpen.be)

Faqja e internetit: [www.antwerpen.be/studiewijzer](http://www.antwerpen.be/studiewijzer)